

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DOKUMENTI I DOKUMENTIT KODI I DOKUMENTIT DATE I DOKUMENTIT			
14.05.2024			
Nr. Prot. Org. Jedin. Org. Unit	Sh. Llogarit. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Org. Prot. Prot. No.	Nr. Fletëve Et. Stranica No. Pages
01	112	570	8



Në zbatim të nenit 12.1 të Ligjit Nr.05 /L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (G.Z. Nr.17/ 10 qershor 2016) si dhe duke pasur parasysh nevojat për edukim dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional siç është përcaktuar me Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit, më datë 14 maj 2024 lidhet kjo:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR TRAJNIME PROFESIONALE

SHKÇAK - DKRRK - SCAAK PRISHTINË	
Nr. 84/24	Nr. i fletëve 6
Data 14/05/24	Nënshkrimi

Ndërmjet:

Zyrës Kombëtare të Auditimit, me adresë në rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 në Prishtinë, përfaqësuar nga Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme (në tekstin e mëtutjeshëm: ZKA) dhe

Shoqatës për Kontabilist të Çertifikuar dhe Auditor të Kosovës, përfaqësuar nga Ardiana Bunjaku, Drejtor Ekzekutiv (në tekstin e mëtutjeshëm: Shoqata).

Bashkërisht të referuar si "Palët"

Përderisa Zyra Kombëtare e Auditimit ua mundëson zyrtarëve të saj trajnimet për Edukim të vazhdueshëm profesional (EVP),

Përderisa Shoqata ofron trajnimet për qëllime të edukimit të vazhdueshëm profesional;

Përmes kësaj Marrëveshje Palët përcaktojnë kushtet, të drejtat dhe detyrimet lidhur me shërbimet profesionale të ofruara për zyrtarët e ZKA nga ana e Shoqatës;

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

Objekt i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i orëve të trajnimit, kushtet e pjesëmarrjes në trajnime në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP) për personelin e ZKA dhe të drejtat e zyrtarëve në Shoqatë të fituara sipas kësaj Marrëveshje.

Neni 2

Orët e trajnimeve në kuadër të EVP-ve

1. Zyrtarët e ZKA, do të vijojnë 10 orë trajnime brenda vitit kalendarik në kuadër të EVP-ve të organizuara nga Shoqata.
2. Në rast të kërkesës për zhvillimin e temave/trajnimeve të tjera (EVP) jashtë Planit vjetor për EVP-të që mund të kërkoen nga ZKA, pagesa do të jetë institucionale, e nivelit të mbulimit të kostove përkatëse për përgatitjen e materialit, pagesën e ligjëruesit, sallat si dhe shpenzimet tjera administrative të implikuara gjatë organizimit dhe të dokumentuara me faturat përkatëse.

Neni 3

Temat dhe orari i mbajtjes së trajnimeve

1. Trajnimet në kuadër të orëve të përcaktuara për EVP-të, përfshijnë tema të caktuara në fushën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit në sektorin publik.
2. Më nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Shoqata e dorëzon në ZKA Planin vjetor të trajnimeve për vitin aktual deri në fund të muajit maj. Zyrtarët e ZKA-së, përcaktohet për temat me interes profesional dhe përmes koordinatorit e njofton Shoqatën për përzgjedhjen e tyre dhe listën e pjesëmarrësve.
3. Në pajtueshmëri me paragrafin paraparak, përfaqësuesit e të dy palëve në koordinim ndërmjet tyre, përcaktohen për grupet e pjesëmarrësve në trajnime si dhe orarin e saktë të mbajtjes së tyre. Trajnimet organizohen gjatë vitit.
4. Në rast se nuk është e mundur të realizohet fondi i orëve të përcaktuara për trajnime dhe përfshirja e të gjithë zyrtarëve në këto trajnime në afatet e përcaktuara, për shkak të fuqisë madhore, dhe atëherë kur ka pajtueshmëri ndërmjet palëve, trajnimet mund të organizohen në një periudhë tjetër të mundshme.
5. Për menaxhimin e kësaj Marrëveshje, nga ZKA si koordinatorë caktohet zyrtarja Ardita Gashi-Bllaca, Zyrtare për zhvillim profesional, kurse nga Shoqata caktohet Burbuqe Gjonbalaj, Udhëheqëse e Departamentit të Shërbimit për Anëtarë.
6. Vijuesit e trajnimeve, Shoqata i pajisë me dëshminë përkatëse / vërtetim për pjesëmarrje në trajnimi përkatës (temat e caktuara).

Neni 4

Literatura dhe cilësia e trajnimeve

1. Materiali i trajnimeve duhet të jetë i përditësuar, sipas ndryshimeve dhe plotësimeve përkatëse të standardeve profesionale apo legjislacionit në fuqi në Kosovë
2. Trajnimet e Shoqatës do të mbahen nga trajnues me kompetencë profesionale për trajnimin përkatës.

Neni 5

Kompensimi për orët e caktuara të trajnimeve

1. Kompensimi bëhet për orët e caktuara të trajnimeve për EVP. Pagesa për numrin e orëve të EVP-ve, sipas paragrafit 1 të nenit 2 të Marrëveshjes paguhet në shumë prej 75€ për secilin zyrtar sipas listës të dërguar nga ZKA e cila do i bashkëngjitet Marrëveshjes. Në rast të ndryshimit të listës gjatë vitit, ZKA e njofton paraprakisht Shoqatën.
2. Pagesa bëhet në llogarinë bankare të Shoqatës, pas përfundimit të trajnimeve dhe pranimit të faturës nga Shoqata. Fatura lëshohet në përputhje me listën e pjesëmarrësve sipas paragrafi 4 të nenit 3 të kësaj Marrëveshje.
3. Pagesa institucionale do të konsiderohet si vazhdimësi në rast se ndonjë zyrtar i ZKA dëshiron të vazhdojë anëtarësinë individuale në sektorin privat.

Neni 6

Përfitimet tjera të ZKA-së

1. ZKA, për qëllime të përditësimit dhe profesionalizimit të zyrtarëve të saj, do të përfitojë nga kjo Marrëveshje edhe të drejtat në vijim:
 - 1.1. Të drejtën që të informohet përmes Shoqatës lidhur me risitë dhe zhvillimet e fundit profesionale në nivel global;
 - 1.2. Të drejtën e Qasjes në forumin dhe rrjetet e tjera të Shoqatës;
 - 1.3. Pajisjen e zyrtarëve me dëshmi (vërtetime) për pjesëmarrje në EVP dhe thirrje profesionale në Shoqatë;
 - 1.4. Fitimi i statusit të anëtarit të asociuar për zyrtarët e ZKA-së në pajtim dhe nën kushtet e përcaktuara me Vendimin nr. 09/2023 të datës 23.05.2023 të Bordit të Shoqatës (bashkëngjitur me këtë Marrëveshje)
 - 1.4. Publikimi i listës së zyrtarë të ZKA-së sipas thirrjeve përkatëse (çertifikimet në sektorin publik dhe privat) në ueb faqen e Shoqatës tek seksioni i Auditorëve nga ZKA .
2. Lidhur me paragrafin 1 më sipër, me përjashtim të pikës 3, përfitimet mes palëve realizohen përmes komunikimit mes palëve të Marrëveshjes dhe jo mes Shoqatës dhe zyrtarëve të ZKA-së direkt .
3. Zyrtarët e ZKA-së që fitojnë statusin e anëtarit të asociuar sipas kushteve nga paragrafi 1, pika 4 i këtij neni, gëzojnë të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të asociuar, të përcaktuara me dispozitat e Statutit e Shoqatës lidhur me subjektet e asociura në Shoqatë.
4. Asocimi në shoqatë për zyrtarët e ZKA-së, sipas dispozitave të këtij neni, vlen deri me datë 31 dhjetor 2024. Vazhdimi i asociimit për vitet e ardhshme do të aktivizohet me nënshkrim të marrëveshjes së radhës.

Neni 7

Mospajtimet

1. Palët janë të detyruara ta zbatojnë këtë Marrëveshje sipas kushteve të përcaktuara dhe mospajtimet e mundshme duhet t'i zgjidhin vetëm me mirëkuptim.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe zbatohet deri më 31.12.2024.
2. Zgjidhja eventuale e Marrëveshjes para skadimit të saj mund të bëhet nga secila Palë në pajtim me kushtet për zgjidhje të kontratave të përcaktuara me Ligjin në fuqi për marrëdhëniet e detyrimeve.
3. Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje, nga një për secilën palë.

Prishtinë, 14 maj 2024


Për ZKA



Vlora Spanca

Auditore e Përgjithshme

Për Shoqatën



Ardiana Bunjaku

Drejtore Ekzekutive